

VENDIM
Nr.799, datë 8.12.2006

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE UNESCO-S, PËR PROJEKTIN “RESTAURIMI I
QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË GJIROKASTRËS”, FINANCUAR NGA
UNESCO-JA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 17 të ligjit nr.8371, datë 13.5.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe UNESCO-s, për projektin “Restaurimi i qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës”, financuar nga UNESCO-ja, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha